

# LICENCË PËR OPERATORIN E TREGUT TË ENERGJISË (ME KUSHTE)

**DHËNË:**

***"KOSTT- OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT  
DHE TREGUT" SH.A***

**Numri i Regjistrimit: ZRRE\_Li\_16/06**

## PASQYRA E PËRMBAJTJES

<b>PJESA I    TERMAT E LICENCËS</b> .....	<b>3</b>
<b>PJESA II   KUSHTET E LICENCËS</b> .....	<b>4</b>
Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet .....	4
Neni 2: Autorizimi i Dhënë Sipas Kësaj Licence .....	6
Neni 3: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Operimit të Tregut.....	6
Neni 4: Detyrimet e Sthurjes Ligjore dhe të Menaxhimit.....	7
Neni 5: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve .....	8
Neni 6: Ndalimi i Diskriminimit.....	8
Neni 7: Rregullat e Tregut .....	8
Neni 8: Qasja në Rregullat e Tregut .....	9
Neni 9: Komunikimet Operacionale .....	90
Neni 10: Disponueshmëria e Kapacitetit .....	10
Neni 11: Tregtimi dhe Emërimi i Ndërlidhësit .....	101
Neni 12: Parashikimi i Operimit të Sistemit.....	11
Neni 13: Llogaritjet Përfundimtare dhe Çmimet e Mosbalancimit të Energjisë .....	11
Neni 14: Taksat e Sistemit .....	11
Neni 15: Faturimi dhe Pagesat.....	11
Neni 16: Kufizimet në Shfrytëzimin e disa Informacioneve .....	11
Neni 17: Puna.....	12
Neni 18: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit .....	123
Neni 19: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së .....	123
Neni 20: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës .....	13
Neni 21: Masat dhe Gjobat Administrative .....	145
Neni 22: Zgjidhja e Kontesteve .....	156

**Shtojca 1:** Përshkrimi i Grupit të të Licencuarit (aksionarët, ortakët dhe nëpunësit e të Licencuarit - diagrami, referenca ndaj disa përqindjeve të pjesëmarrjes aksionare dhe aktiviteteve të ushtruara nga secila kompani).

**Shtojca 2:** Përshkrimi i aktiviteteve të tjera të ushtruara nga i Licencuari, ndarë në aktivitetet e sektorit të energjisë dhe aktivitetet e sektorëve të tjerë.

## PJESA I    TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje "ZRRE ")**, gjatë ushtrimit të autoritetit të dhënë prej Neneve 15.2 (a), dhe 37 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë (tani e tutje "Ligji") dhe Nenit 16.2 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 2004/8), dhe Nenit 27 të Ligjit për Energjinë Elektrike, me anë të kësaj, i lëshon **KOSTT-OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT SH.A.** (tani e tutje "i Licencuari"), këtë licencë për sigurimin e menaxhimit ekonomik të sistemit të energjisë elektrike (**Licenca për Operatorin e Tregut**), gjatë periudhës së specifikuar në paragrafin 5, sipas Neneve dhe Kushteve të përcaktuar në Pjesën e II.
2. Territori i mbuluar nga kjo licencë është i gjithë territori i Kosovës (tani e tutje "Territori").
3. I Licencuari do të veprojë në pajtim me Nenet dhe kushtet e përfshira në këtë licencë, dhe me kërkesat e Nenit 27 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të gjithë legjislativioneve përkatëse dhe udhëzimet e ZRRE-së, dhe në çdo kohë të jetë në pajtim me objektivat e aplikueshme si në vijim:
  - a) kryerjen efikase të detyrimeve që i janë vendosur të Licencuarit nga kjo licencë;
  - b) promovimin e konkurrencës efektive në gjenerimin, tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike, dhe promovimin e kësaj konkurrence për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
  - c) promovimin e efikasitetit në zbatimin dhe administrimin e Rregullave të Tregut;
  - d) zbatimin dhe menaxhimin efikas të marrëveshjeve balancuese dhe rregulluese të siguruara me Rregullat e Tregut.
4. Nenet dhe kushtet e kësaj licence i nënshtrohen modifikimit ose përfundimit, ose tërheqjes në përputhje me kushtet e veta dhe me Nenet 35, 36, 37 dhe 39 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
5. Kjo licencë do të hyjë në fuqi me 4 Tetor 2006 dhe, pos nëse tërhiqet, do të jetë në fuqi deri më 4 Tetor 2036 me mundësi që të vazhdohet sipas Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë .

Vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji, më \_\_\_\_\_.

Nënshkruar nga (në emër të Bordit të ZRRE-së) \_\_\_\_\_

## **PJESA II KUSHTET E LICENCËS**

### **Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet**

1. Për qëllimet e kësaj licence, termat dhe shprehjet e renditura më poshtë, do të kenë kuptimin vijues:

**"Marrëveshja për qasje"** nënkupton dokumentin e nënshkruar nga të gjitha palët të cilat bien dakord të veprojnë sipas Rregullave të tregut siç përcaktohet në Shtojcën 2 të Rregullave të Tregut.

**"Anëtar"** nënkupton në marrëdhënie të drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo Kompani Aksionare apo Vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një Kompanie Aksionare të të Licencuarit, në secilin rast brenda kuptimit të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

**"Kodi i Shpërndarjes"** nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

**"Sistemi i Shpërndarjes"** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

**"Operatori i Sistemit të Shpërndarjes( OSSh)"** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

**"Pala Dominante"** ka kuptimin e dhënë në Rregullat e Tregut.

**"Ndërmarrje për energjinë elektrike"** ka kuptimin e dhënë sipas Nenit 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

**"Viti financiar"** është periudha prej 1 Janarit deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

**"Njësi gjenerimi"** nënkupton çdo centralë apo aparat për gjenerimin e energjisë elektrike siç parashihet në Kodin e Rrjetit Elektrik.

**"Kodi i Rrjetit Elektrik"** nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit sipas Ligjit të Energjisë Elektrike aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

**"Kompani Aksionare"** nënkupton çdo kompani e definuar si e tillë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

**"Legjislacion"** është Ligji për Energjinë (2004/8), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (2004/9), Ligji për Energjinë Elektrike (2004/10) dhe legjislacioni tjetër parësor ose dytësor që do të nxirret për të ekzekutuar legjislacionin parësor në rregullimin e sektorit të energjisë.

**"Operatori i Tregut"** nënkupton një person juridik përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtisë së energjisë elektrike dhe marrëveshjet për pagesë midis prodhuesve, furnizuesve dhe konsumatorëve.

**“Rregullat e Tregut”** nënkuptojnë grup rregullash të miratuara nga ZRRE që udhëheqin tregtinë e energjisë midis Operatorit të Tregut dhe ndërmarrjeve tjera të energjisë elektrike, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit, me qëllim të mirëmbajtjes së balancës fizike të tregut. Kjo përfshinë çdo marrëveshje kalimtare mbi tregtimin që do të mund të aprovohej nga ZRRE-ja.

**“Marrëveshja Kornizë e Rregullave të Tregut”** ka kuptimin siç është përcaktuar në Rregullat e Tregut.

**“Modifikim”** përfshin shtimin, ndryshimin dhe zëvendësimin, dhe shprehjet e përafërta që do të interpretohen në përputhje me rrethanat.

**“Tregu i Organizuar”** nënkupton rangun e organizuar të transaksioneve dhe raporteve komerciale në tregtimin e energjisë elektrike, ku, vendi, koha dhe metoda e përmbylljes së transaksioneve dhe krijimi i raporteve komerciale dihen publikisht dhe janë njoftuar më herët në Rregullat e Tregut.

**“Llogaritje përfundimtare”** ka kuptimin e dhënë në Rregullat e Tregut.

**“Vartës”** nënkupton çdo kompani në pronësi apo e kontrolluar nga një kompani tjetër, e që definohet sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

**“Sistemi i Transmisionit”** ka kuptimin e dhënë në Nenit 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

**“Operatori i Sistemit të Transmisionit”** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

**“Pala Tregtuese”** ka kuptimin e dhënë në Rregullat e Tregut.

**“Ndërmarrje e integruar vertikalisht”** nënkupton ndërmarrjen e energjisë elektrike e cila kryen të paktën një nga funksionet për të cilat kërkohet licenca sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, përveç transmisionit të energjisë elektrike.

2. Termat e përdorur në këtë Licencë do të kenë të njëjtat kuptime si termat e përdorur në Legjislacion.
3. Duke iu referuar paragrafit 2, çdo modifikim ose ri-dekretim i legjislacionit pas datës kur kjo licencë hyn në fuqi, do të aplikohet
4. Përveçse nëse specifikohet ndryshe:
  - a) çdo referencë në një Nen të numëruar ose në një Shtojcë të numëruar, është respektivisht një referencë në Nen apo Shtojcën që mban atë numër në këtë licencë;
  - b) çdo reference në një paragraf të numëruar, është një reference në paragrafin që mban të njëjtin numër në Nenin ose në Shtojcën ku shfaqet referenca.
5. Titulli ose tema e ndonjë Pjese, Neni, Shtojce ose paragrafi, nuk do të ndikojë në kuptimin e saj.

6. Kur të Licencuarit i imponohet për të kryer një detyrim brenda një afati të specifikuar, ai detyrim duhet të vazhdojë të jetë detyrues dhe në fuqi edhe pas atij afati kohor, pa marrë parasysh masat dhe gjobat administrative që mund të vendosen kundër të Licencuarit, nëse ky i fundit nuk e kryen aktivitetin e duhur brenda afatit kohor.
7. Dispozitat e paragrafit 6 do të aplikohen në çdo dokument, udhëzim, njoftim dhe shërbimi që duhet të kryhet sipas kësaj licence dhe udhëzimeve të lëshuara prej ZRRE-së.

## **Neni 2: Autorizimi i Dhënë Sipas Kësaj Licence**

1. Sipas Rregullave të Tregut , i Licencuari është i autorizuar që të:
  - a) qaset në Rregullat e Tregut në pozitën e “pronarit”;
  - b) mbajë një proces për të gjithë Palët Tregtare që të qasen në Rregullat e Tregut;
  - c) mbajë llogaritë në emër të Palëve Tregtare dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Shpërndarjes;
  - d) menaxhojë procesin e Llogaritjes përfundimtare;
  - e) faturojë dhe mbledhë paratë që i detyrohen Palëve Tregtare ose që këto të fundit i kanë borxh (sipas rastit), sipas kushteve të Rregullave të Tregut;
  - f) veprojë si agjent i Operatorit të Sistemit të Transmisionit, të faturojë dhe të mbledhë taksat që i detyrohen Palëve Tregtare ose që këto të fundit i kanë borxh (sipas rastit), siç lejohet nga kjo licencë që i jepet Operatorit të Sistemit të Transmisionit nga ana e ZRRE-së;
  - g) veprojë si agjent i Operatorit(ve) të Sistemit të Shpërndarjes, të faturojë dhe të mbledhë taksat që i detyrohen Palëve Tregtare ose që këto të fundit i kanë borxh (sipas rastit), siç lejohet nga kjo licencë që i jepet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga ana e ZRRE-së;
  - h) menaxhojë procesin e Modifikimit të Rregullave të Tregut;
  - i) sigurojë informacione mbi tregun në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut; dhe
  - j) përmbushë funksione të tjera që i janë caktuar sipas Rregullave të Tregut.
2. I Licencuari nuk do të caktojë dhe/ose transferojë, dhe as nuk do të ketë për qëllim të caktojë ose transferojë ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e veta që i janë dhënë me anë të kësaj licence.

## **Neni 3: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Operimit të Tregut**

### **Kushti 1:**

Sipas Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë i Licencuari duhet të veprojë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e këtij Neni brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence.

1. I Licencuari do të përgatisë llogaritë vjetore rregullative në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, nxjerrë nga ZRRE-ja dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të kontabilitetit vjetor të audituar përgatitur sa më shpejt që është e mundur, dhe i cili duhet të dorëzohet brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar për të cilin kanë të bëjnë llogaritë.

2. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë llogari të ndara për biznesin e operimit të tregut në tërësi (ndaras nga veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Transmisionit), i cili në rast se kërkohet kohë pas kohe nga ZRRE-ja, duhet t'i dorëzohet ZRRE-së në formën dhe datën e specifikuar nga ZRRE-ja. Llogaritë duhet të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, që nxirren kohë pas kohe nga ZRRE-ja.
3. Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet që ZRRE-ja i njofton të Licencuarit sipas paragrafit 2, ndër të tjerash mund të:
  - a) specifikojnë formën e regjistrave/pasqyrave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në llogaritë e fitimit dhe humbjes (bilanci i suksesit), bilancin e gjendjes, fitimet e njohura dhe pasqyrat e humbjeve, rrjedha e parave të gatshme (cash-flow) dhe deklaratat për shumatat e të ardhurave, shpenzimeve, asetëve, detyrimeve, rezervave ose kushteve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis biznesit të konsoliduar të operimit të tregut dhe ndonjë biznesi tjetër;
  - b) të specifikojë natyrën dhe përmbajtjen e regjistrave/pasqyrave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose detyrimeve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe detyrimet nga aktivitetet e specifikuara;
  - c) të specifikojë parimet e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse ZRRE-ja nxjerr më parë udhëzimet për qëllimet e këtij Neni ose nëse ZRRE-ja jep paraprakisht aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do të veproj në përputhje me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja e për qëllim të këtij Neni.

#### **Neni 4: Detyrimet e Sthurjes Ligjore dhe të Menaxhimit**

1. Për sa kohë që i Licencuari është pjesë e një ndërmarrjeje të integruar vertikalisht, ai duhet të veproj në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 27 të Ligjit për Energjinë Elektrike, të siguroj pavarësinë e tij nga aktivitetet që nuk kanë të bëjnë me Transmisionin për sa i përket formës ligjore, pronësisë, organizimit dhe vendimmarrjes.
2. I Licencuari nuk ka të drejtë të jetë i angazhuar në gjenerim të energjisë elektrike, furnizim publik dhe ose furnizim / tregtim.
3. Në mënyrë që të sigurojë pavarësinë e të Licencuarit:
  - a) ata persona që janë përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë direkt ose indirekt në strukturat e kompanisë së integruar vertikalisht që është përgjegjëse, për funksionimin e përditshëm të gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike;

- b) i Licencuari do të marrë masat e duhura për të siguruar që të merren parasysh interesat profesionale të personit përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit, në mënyrën që siguron se ata janë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur;
- c) i Licencuari do të krijojë Kodin e Sjelljes ku përcaktohen masat që janë të nevojshme për të siguruar përjashtimin e sjelljeve diskriminuese dhe monitorimin e duhur të respektimit të këtyre masave. Ky Kod do të miratohet nga ZRRE-ja. Kodi i Sjelljes do të përfshijë detyrimet specifike të drejtorëve dhe punonjësve të të Licencuarit për të plotësuar këtë objektiv, përfshirë detyrimet e mos-konkurrencës, fshehtësinë dhe shmangien e konflikteve të interesave. Kodi i Sjelljes do të bëjë pjesë në çdo kontratë punësimi me të Licencuarin. I Licencuari do të dorëzojë çdo vit në ZRRE një raport vjetor ku tregohen masat e ndërmarra për pajtueshmërinë me Kodin e Sjelljes. Ky raport do të dorëzohet më së voni më 31 janar të çdo viti.

### **Neni 5: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve**

I Licencuari do të sigurojë që biznesi i Operatorit të Tregut nuk do të japë ndonjë ndër-subvencion (direkt apo indirekt) apo nuk do ta marrë ndonjë subvencion (direkt apo indirekt) prej ndonjë biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartësi apo ndërmarrjeje partnere të të Licencuarit.

### **Neni 6: Ndalimi i Diskriminimit**

1. I Licencuari nuk do të bëjë diskriminime midis Palëve Tregtare, veçanërisht në favor të Vartësve apo ndërmarrjeje partnere të tij, dhe do të kryejë funksionet e veta duke respektuar parimet e transparencës, objektivitetit dhe pavarësisë.
2. Pala Tregtare që është caktuar nga ZRRE-ja si Palë Dominante, mund të trajtohet ndryshe nga i Licencuari, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.

### **Neni 7: Rregullat e Tregut**

#### **Kushti 2:**

Brenda periudhës jo më gjatë se **tre (3) muaj** nga data e hyrjes në fuqi të Rregullave të Tregut, i Licencuari është i obliguar që të bëjë marrëveshje për të gjitha Ndërmarrjet e Energjisë Elektrike të licencuara në Kosovë përfshirë edhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Ndërmarrjet e Energjisë me Njësi Gjenerimi që të nënshkruajnë Marrëveshjen Kornizë për Rregullat e Tregut apo ndonjë Marrëveshje relevante me të cilën Palët pajtohen që të lidhen me Rregullat e Tregut. ZRRE mund të lëshojë udhëzime me qëllim të ndryshimit të afatit të përcaktuar me këtë Kusht ashtu si precizohet në udhëzimet e tilla.

1. 120 ditë brenda datës së nxjerrjes së kësaj licence apo ndonjë afati më të shkurtër që ZRRE-ja mund të caktojë, i Licencuari do të përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE Rregullat e Tregut që i propozon për tu aplikuar.
2. Në përputhje me Nenin 15.2 j) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullat e Tregut i nënshtrohen miratimit të ZRRE-së. Për më tepër, kur këto Rregulla të Tregut janë miratuar nga ZRRE-ja, ato nuk mund të ndryshohen pa marrëveshjen me shkrim të ZRRE-së.
3. I Licencuari do të jetë përgjegjës për menaxhimin e çdo modifikimi të Rregullave të Tregut, sipas dispozitave përkatëse të Rregullave të Tregut, si dhe të dërgoj çdo propozim për

modifikim në ZRRE për miratim pas konsultimit adekuat me palët që do të preken me këtë modifikim. Kur ZRRE e udhëzon, i Licencuari do të ndërmer veprimet për modifikimin e Rregullave të Tregut e në përputhje me udhëzimet e ZRRE-së.

4. I Licencuari do të botojë Rregullat e aplikueshme të Tregut në faqen e tij elektronike zyrtare, në një formë që mund të shkarkohet dhe kopjohet lehtë, dhe do të jetë përgjegjës për të siguruar kopje të Rregullave të Tregut çdo personi sipas kërkesës. Personi i nënshtrohet pagesës së një shume e cila nuk e kalon shumën e kostove të arsyeshme që i Licencuari shpenzon për të bërë dhe siguruar kopjet. Shuma e caktuar do të miratohet nga i Licencuari herë pas here dhe do të botohet në faqen e vet elektronike zyrtare.

#### **Neni 8: Qasja në Rregullat e Tregut**

1. I Licencuari do të hyjë në Marrëveshje për Qasjen me të gjithë personat që dëshirojnë të nënshkruajnë një marrëveshjet të tillë dhe të bëhen Palë në Rregullat e Tregut, dhe për këtë do të njoftojnë ZRRE-në në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.
2. I Licencuari është i detyruar të monitorojë përputhshmërinë e Palëve Tregtuese me termat dhe kushtet e Marrëveshjeve të Qasjes, në përputhje me Rregullat e Tregut.
3. I Licencuari mund ti përfundojë këto Marrëveshje të Qasjes në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.
4. I Licencuari do t'u vendosë Palëve Tregtuese tarifa të aplikueshme për pjesëmarrjen në Treg (Tarifat e Operatorit të Tregut), si dhe me ndonjë shumë të nevojshme për të siguruar Tregun, siç përcaktohet nga Rregullat e Tregut.

#### **Neni 9: Komunikimet Operacionale**

1. Për qëllimet e menaxhimit të Llogaritjeve përfundimtare, i Licencuari do të siguroj dhe do të instalojë një kompjuter të përshtatshëm dhe pajisjet dhe softuerin, si dhe do të hartojë dhe do të botojë standardet e nevojshme për komunikimin me këtë softuer, duke përdorur standardet ndërkombëtare, e në përputhje me Rregullat e Tregut.
2. I Licencuari do të sigurojë që Softueri për Llogaritjet përfundimtare të kontrollohet nga kompania e duhur, e pavarur dhe e kualifikuar e auditimit, për të përcaktuar përputhshmërinë me Rregullat e Tregut, në pajtim me dispozitat e Rregullave të Tregut.
3. I Licencuari do të mirëmbajë shënime të plota dhe të sakta të të gjithë të Dhënave për Llogaritjet përfundimtare që janë paraqitur nga Palët Tregtare ose që janë mirëmbajtur nga i Licencuari. Formatit për ruajtjen e këtyre shënimeve do të përcaktohet nga i Licencuari.
4. Për qëllimet e këtij Neni:

*“Të Dhënat e Llogaritjes përfundimtare”* do të jenë të gjitha të dhënat që sipas Rregullave të Tregut, nevojiten të furnizohen nga i Licencuari ose nga Palët Tregtare që mundësojnë kryerjen e Llogaritjes përfundimtare sipas Rregullave të Tregut.

## **Neni 10: Disponueshmëria e Kapacitetit**

1. I Licencuari do të krijojë, mirëmbajë dhe do të rifreskojë regjistrin (regjistrin e kapacitetit) në të cilin do të regjistrohet kapaciteti i deklaruar i çdo Njësie Gjeneruese, numrin e Certifikatave të Disponueshmërisë së Kapacitetit (CDK) që ka secila Palë Tregtare për çdo Periudhë të Llogaritjes përfundimtare dhe të gjitha transaksionet në lidhje me CDK-në, përfshirë propozimet për transferimet dhe njoftimet e CDK-së, në përputhje me Rregullat e Tregut. .
2. I Licencuari do të bashkëveprojë me Operatorin e Sistemit të Transmisionit për identifikimin e disponueshmërisë së Njësive Gjeneruese, dhe do të regjistrojë historinë e plotë të njoftimeve për disponueshmërinë e kapacitetit, të cilat janë dorëzuar nga Palët Tregtare siç përcaktohet në Rregullat e Tregut.
3. I Licencuari do t'u japë CDK-në Njësive të Gjenerimit dhe Tregtarëve të Linjave të Ndërlidhjes, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.
4. I Licencuari do t'i dorëzojë çdo Palë Tregtare raporte për transferimet e CDK-së, nëse në përputhje me Rregullat e Tregut, kjo i përket asaj pale.
5. Për qëllime të këtij Neni:

*“ Certifikata mbi Disponueshmërinë e Kapaciteteve”* ka kuptimin e dhënë si në Rregullat e Tregut.

*“ Tregtarë të Linjave Ndërlidhëse”* ka kuptimin e dhënë si në Rregullat e Tregut.

## **Neni 11: Tregtimi dhe Përcaktimi i Ndërlidhësit**

1. I Licencuari do të krijojë, mirëmbajë dhe do të rifreskojë regjistrin e kapacitetit Ndërlidhës, në të cilin do të regjistrojë informacione mbi llogaritë e kapacitetit Ndërlidhës në emër të çdo personi që dëshiron të mbajë të drejtat e kapacitetit Ndërlidhës dhe të dorëzojë të dhënat dhe provat e kërkuara në lidhje me aftësinë për të paguar për të drejtat e kapacitetit të Ndërlidhjes, e në përputhje me Rregullat e Tregut. .
2. I Licencuari do të bë publike të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të përshtatshëm për kryerjen e shitjes vjetore ose mujore të kapacitetit, si dhe për caktimin e kapacitetit Ndërlidhës në baza ditore, në përputhje me Rregullat e Tregut.
3. I Licencuari do të jetë përgjegjës për përshkrimin e formës së transferimit të të drejtave të kapacitetit Ndërlidhës nga një Palë Tregtare, në një tjetër, si dhe për pranimin ose refuzimin e propozimeve të Tregtimit Ndërlidhës, në përputhje me Rregullat e Tregut.
4. Në emër të Palëve Tregtare, i Licencuari do t'i dorëzojë Operatorit të Sistemit njoftimet ku specifikohen shpërndarjet e synuara në MW ose marrjen në një ditë të caktuar përmes një Ndërlidhësi (nominimet fizike të Ndërlidhësit) dhe është i detyruar të sigurojë informacionin e nevojshëm të gjitha Palëve Tregtare të cilat kanë marrë të drejtat e kapacitetit Ndërlidhës, në përputhje me Rregullat e Tregut.
5. Për qëllime të këtij Neni:

“*Ndërlidhës*” ka kuptimin e dhënë si në Rregullat e Tregut dhe Kodin e Rrjetit Elektrik.

#### **Neni 12: Parashikimi i Operimit të Sistemit**

I Licencuari do të jetë përgjegjës për botimin në faqen elektronike zyrtare dhe mirëmbajtjen e shënimeve në kohën e duhur të të gjithë informacioneve që kanë të bëjnë me parashikimet vjetore, mujore dhe “një ditë përpara” të kërkesave dhe faktorët tjerë, ashtu siç atij ja siguron Operatori i Sistemit të Transmisionit, e në përputhje me Rregullat e Tregut .

#### **Neni 13: Llogaritjet Përfundimtare dhe Çmimet e Mosbalancimit të Energjisë**

1. I Licencuari do të jetë përgjegjës për llogaritjet përfundimtare të ofertave dhe kontratave të propozuara përmes llogarive përkatëse energjetike, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.
2. I Licencuari do të përlllogarisë dhe do të botojë çmimin e mosbalancimit të energjisë për çdo Periudhë të Llogaritjes përfundimtare në përputhje me Rregullat e Tregut.
3. I Licencuari është i detyruar të përlllogarisë energjinë e njehsuar dhe ofertën e pa-dorëzuar si dhe të ofrojë vëllime për sa i përket llogarive përkatëse të energjisë, në përputhje me Rregullat e Tregut, si dhe është përgjegjës për krijimin e këtyre llogarive.
4. Për llogaritjen përfundimtare të mosbalancimeve të kapacitetit, i Licencuari do të përlllogarisë dhe do të vendosë gjoba për kapacitetin, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.
5. Për qëllime të këtij Neni:

“*Periudha e Llogaritjes përfundimtare*” ka kuptimin e dhënë si në Rregullat e Tregut.

#### **Neni 14: Taksat e Sistemit**

Duke vepruar në aftësinë e agjentit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, I Licencuari, do të marrë nga Palët Tregtare të gjithë pagesat e aplikueshme për shfrytëzim të sistemit dhe ti transferoj ato Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

#### **Neni 15: Faturimi dhe Pagesat**

1. I Licencuari, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut do të jetë përgjegjës për nxjerrjen dhe dorëzimin e faturave Palëve Tregtare të nevojshme për rregullimin e Llogaritjet barazuese të tyre.
2. Duke ju referuar paragrafit 1, i Licencuari do të krijojë një Doracak të faturimit ku specifikohen formatet e faturave dhe të dhënave të tjera.

#### **Neni 16: Kufizimet në Shfrytëzimin e Disa Informacioneve**

1. I Licencuari nuk duhet të zbulojë informacionet konfidenciale ndaj ndonjë biznesi tjetër të Licencuarit ose ndonjë Vartësi apo ndërmarrjeje tjetër të tij, në mënyrë direkte ose

indirekte, përveç në rast se Rregullat e Tregut mundësojnë botimin e informacioneve të tilla.

2. Siç përcaktohet në Rregullin mbi Fshehtësinë e Informatave të miratuar nga ZRRE-ja, i Licencuari mund të zbulojë çdo informacion përveç atij që është i fshehtë dhe që mbahet dhe/ose është fituar gjatë kryerjes së funksioneve të veta si Operator i Tregut. Kjo ndalesë nuk do ta parandalojë të Licencuarin që të zbulojë çdo informatë që ZRRE mund ta kërkojë gjatë kryerjes së obligimeve dhënë asaj me Legjislacionin dhe sipas Nenit 20 të kësaj Licence.
3. I Licencuari do të sigurojë që çdo dokument që përfshinë informata konfidenciale duhet të shënjohej si e tillë.
4. I Licencuari do të marrë masat për të parandaluar zbulimin e informacioneve të fshehta nga çdo person i cili është ose nuk është më i punësuar nga i Licencuari.
5. I Licencuari do të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që ky informacion nuk do të përdoret ose zbulohet për qëllime të tjera përveç atyre për të cilat është siguruar, e në përputhje me dispozitat e Rregullit mbi Fshehtësinë e Informacioneve.
6. Për qëllimet e këtij Neni:

**“Informacion i fshehtë”** është çdo informacion i ndjeshëm nga aspekti komercial apo aspekti tjetër dhe që mbahet dhe/ose është fituar nga i Licencuari gjatë kryerjes së detyrave të veta sipas Legjislacionit, dhe i cili informacion konsiderohet si i fshehtë sipas Rregullit mbi Fshehtësinë e Informacioneve dhe kësaj Licence.

#### **Neni 17: Puna**

I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me të gjithë Ligjet e aplikueshëm në marrëdhënie pune dhe sigurim në punë, qofshin ata në fuqi prej kësaj date, ose në të ardhmen.

#### **Neni 18: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll të të Licencuarit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para ndryshimit. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon.

#### **Neni 19: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së**

1. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE informacione të cilat ZRRE-ja i konsideron si të nevojshme sipas Neneve dhe kushteve të kësaj Licence dhe sa herë që ZRRE-ja mund të kërkojë një gjë të tillë, për qëllimet e kryerjes së funksioneve që i janë caktuar ose transferuar atij sipas Nenit 29 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë apo legjislacionit tjetër të aplikueshëm.
2. Informata duhet të përgatitet në nivel të auditivit ashtu si mund të kërkohet nga ZRRE-ja kohë pas kohe.

3. Kompetenca e ZRRE-së për të kërkuar informacione sipas paragrafit 1, nuk e cenon kompetencën e ZRRE-së për të kërkuar edhe informata që konsiderohen konfidenciale sipas ndonjë Neni apo kushti tjetër të kësaj licence ose legjislacionit të aplikueshëm.
4. Nëse i Licencuari kërkon që ndonjë dokument të konsiderohet konfidencial, ai ka për obligimi që të shënoj dokumentin e tillë si konfidencial dhe të justifikoj këtë tek ZRRE-ja.
5. I Licencuari do të dërgoi ZRRE-së raporte tremuajshe dhe vjetore mbi veprimtarinë e operatorit të tregut dhe pajtueshmërinë me Nenet dhe kushtet e licencës e në përputhje me Doracakun e Raportimit të nxjerrë nga ZRRE-ja.
6. I Licencuari do të dërgoi ZRRE-së detajet për çdo ndryshim në informata që janë dorëzuar gjatë aplikacionit për këtë licencë.
7. Në këtë Nen:

**"Informacioni"** është material, në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

#### **Neni 20: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës**

1. ZRRE-ja mund të përfundojë këtë licencë në rastet e përmendura në Nenin 39 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë nëse obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër ose që konsumatorët nuk do të jetë në pozitë të pa lakmueshme për shkak të përfundimit. Përfundimi i tillë do të ndërmerret në rast të:
  - a) skadimit të afatit të licencës;
  - b) me kërkesë të të Licencuarit lidhur me licencën e tij;
  - c) shuarjen e personit ligjor që mban licencën;
  - d) me vendim të gjykatës që deklaron falimentimin e të Licencuarit, ose me anë të vendimit të gjykatës për të përfunduar operimin e tregut për shkak të deklaratës së të Licencuarit rreth falimentimit të tij;
  - e) nëse një aktivitet i licencuar energjetik nuk është drejtuar për më shumë se gjashtë (6) muaj, përveç në rast kur pezullimi i aktivitetit është kryer me miratim të ZRRE-së;
  - f) nëse janë përmbushur dispozitat e Nenit 44 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve Energjetike në Kosovë;
  - g) nëse shuma e taksës që duhet paguar nuk është paguar për tridhjetë (30) ditë pasi është dashur të paguhet, dhe mbetet e papaguar për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh të tjera pasi të Licencuarit i është dërguar njoftimi me shkrim nga ZRRE-ja se pagesës i ka kaluar afati, me kusht që ky njoftim nuk do të jepet më herët se sa dita që pason "ditën" në të cilën është dashur të paguhet shuma e taksës.
2. ZRRE-ja mund të tërheqë këtë licencë në rastet vijuese, siç përcaktohet në Nenin 44.5 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, me kusht që detyrimet e të Licencuarit të kryhen nga një i Licencuar tjetër ose që konsumatorët të mos jenë në disavantazh nga kjo tërheqje:

- a) i licencuari nuk arrin ti plotësoj ose shkel kushtet materiale të Neneve, kushtet ose detyrimet e licencës dhe këto të fundit nuk janë ndrequr brenda afatit përfundimtar të dhënë nga ZRRE-ja, ose ka dëmtuar seriozisht cilësinë, sigurinë dhe seriozitetin e shërbimit që i Licencuari kundërvajtës ka qenë i detyruar të sigurojë;
  - b) monitorimi i licencës nga ZRRE-ja gjen dështim në përmbushjen e kriterëve administrative, dhe ky dështim nuk është ndrequr brenda afatit përfundimtar të dhënë nga ZRRE-ja;
  - c) i Licencuari ka paraqitur informacione të rreme mbi të cilat është bazuar dhënia e licencës.
3. Në përputhje me Nenin 35 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ZRRE-ja mund të modifikojë licencën në rastet në vijim:
- a) me kërkesë të të Licencuarit;
  - b) nëse nevojitet për të mbrojtur sistemin energjetik në Kosovë, në lidhje me sigurinë e furnizimit ose sigurinë e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, ose në lidhje me mbrojtjen e ambientit.
  - c) në mënyrë që të mbështes kriteret e reja që janë përcaktuar në marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligjet, rregulloret vendore, si dhe në legjislacione të tjera të aplikueshme;
  - d) si sanksion për shkeljen e kushteve dhe termave të licencës, sipas nenit 44 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

### **Neni 21: Masat dhe Gjobat Administrative**

1. Në rast të shkeljes së ndonjë dispozite të Legjislacionit dhe të ndonjë Neni apo kushti të kësaj licence si dhe ndonjë udhëzimi që ZRRE-ja i ka dhënë të Licencuarit, ZRRE-ja do të ketë autoritetin që sipas Nenit 56.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit për Masat dhe Gjobat Administrative, që ose të parandalojë të Licencuarin që të përsërisë veprimin e paligjshëm, ose në rast se veprimi është ndalur, të nxjerrë një vendim rregullativ ku kërkohet që të ndërmerret një veprim i caktuar ose të vendosen gjoba administrative ndaj të Licencuarit dhe/ose anëtarëve të Bordit të tij të Drejtorëve dhe/ose zbatuesve të tij.
2. Përpara nxjerrjes së një gjobe, ZRRE-ja do t'i japë të Licencuarit njoftimin për shkeljen e licencës dhe do t'i japë të Licencuarit mundësinë për t'iu përgjigjur ZRRE-së me shkrim brenda katërmëdhjetë (14) ditësh prej njoftimit, në mënyrë që të ndreqë shkeljen.
3. Në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit për Gjobat dhe Masat Administrative, gjoba do t'i vihet të Licencuarit në rast se ai shkel kërkesat e Nenit dhe përderisa ato janë të aplikueshme për të Licencuarin.
4. Shuma e gjobës do të vlerësohet në përputhje me Rregullin për Masat dhe Gjobat Administrative. Në çdo rast, nëse të Licencuarit i vihet gjoba e përmendur në paragrafin 3, kjo nuk duhet të tejkalojë 15% të të ardhurave neto të të Licencuarit nga veprimtaria e ushtruar sipas kësaj licence në vitin financiar paraparak.
5. Nëse gjoba e përmendur në paragrafin 3 i vendoset një anëtarit të Bordit të Drejtorëve ose një zbatuesi (ekzekutivi) të të Licencuarit, shuma nuk duhet të tejkalojë 300% të pagës mujore që ai person pranon nga i Licencuari.

6. Në rast të shkeljeve të përsëritura, gjoba e vendosur mund të jetë tre (3) herë më e madhe se shuma e autorizuar në paragrafët 4 ose 5.
7. Në përputhje me këtë Nen, kur ZRRE-ja vendos një gjobë, duhet të marrë parasysh shkallën e dëmit social të veprimit, sjelljen e mëparshme të të Licencuarit apo personit në fjalë dhe situatën e financiare të të Licencuarit apo personit.
8. Nëse gjoba e vendosur nga ZRRE-ja nuk paguhet, ZRRE-ja do të fillojë procedurat gjyqësore për mbledhjen e gjobës si borxh civil.

#### **Neni 22: Zgjidhja e Kontesteve**

1. Çdo kontest që lind për shkak të aktivitetit të licencuar, do të zgjidhet në përputhje me Rregullin për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, që është miratuar nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së në lidhje me modifikimin, tërheqjen ose përfundimin e licencës, si dhe ato që kanë të bëjnë me gjobat që rrjedhin prej shkeljeve të licencës ose të legjislacionit të aplikueshëm, mund të apelojnë nga i Licencuari në gjykatën kompetente .